

LIGJ
Nr.8345, datë 13.5.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7811, DATË 12.4.1994 "PËR MIRATIMIN ME
NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.782, DATË 22.2.1994 "PËR SISTEMIN FISKAL NË
SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KËRKIM-PRODHIM)""**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Paragrafi i parë i pikës 2 të nenit 1 të dekretit nr.782, datë 22.2.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)", miratuar me ligjin nr.7811, datë 12.4.1994, ndryshohet si vijon:

"Në rast se kontraktuesi, në përputhje me nenn 12 pika 2 të ligjit "Për hidrokarburet" është Albpetroli dhe ky zotëron më shumë se 40 për qind të interesave në marrëveshje hidrokarburesh dhe asnjë aksioner tjetër nuk zotëron direkt ose indirekt një pjesëmarrje më të lartë, tatimi është:"

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2096, datë 18.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani